

## Informata për dhunën në familje

### Çka është dhuna në familje?

Ju jeni e/i prekur nga dhuna në familje apo nga (ish-) partneriteti. Me dhunën në familje nënkuptohet dhuna trupore, psiqike apo seksuale mbrenda familjes në lidhjen aktuale të çiftit apo atë të zgjidhur. Për shembull:

- Dhuna trupore në lidhjen e çiftit (partneritet)
- Dhuna trupore ndaj fëmijëve nga prindërit
- Kërcënimet apo dhuna psiqike në lidhjen e çiftit
- Stalking nga ish-partneri apo ish-partnerja
- Përdhunimi në martesë
- Ndërhyrjet seksuale në familje
- Keqpërdorimet nga të afërmit përgjegjës apo që përkujdesen
- Dhuna e fëmijëve ndaj prindërve
- Kanosja apo realizimi me ngulm i një martese të detyruar

### Çka mund të bëjmë ne për ju?

Zyra për Mbrojtjen e Viktimave ju mbështet të gjeni rrugëdalje për të dalë nga situata e dhunës. Ne ju njoftojmë për të drejtat tuaja dhe ju ndërmjetësojmë ju dhe fëmijëve tuaj në ndihma tjera:

- Ne ju dëgjojmë ju ashtu që që ju të mund të shpreheni se çka keni përjetuar.
- Ne ju ndihmojmë të mendoni se si ju mund t'i jepni fund dhunës.
- Ne ju ndihmojmë të vendosni se si mund të vazhdoni më tutje, për shembull në lidhje me ndarjen/shkurorëzimin.
- Ne ju ndërmjetësojmë ndihma tjera, për shembull një avokat, ndihmë psikologjike apo ndihmë financiare.
- Ne juve mund t'ju ndihmojmë edhe për ta gjetur një vend të mbrojtur për ju dhe fëmijët tuaj.

### Cilat janë të drejtat tuaja të përgjithëshme?

- Ju si person i prekur mund të zgjidhni vetë nga cila Zyrë për Mbrojtjen e Viktimave dëshironi të ndihmoheni (Vendndodhjet në gjithë Zvicrën). Informatat tjera i gjeni në [www.opferhilfe-schweiz.ch](http://www.opferhilfe-schweiz.ch).
- Ju keni të drejtë për këshilla juridike, sociale dhe psikologjike.
- Shërbimet e zyrës sonë janë papagesë. Personat këshilldhënës janë të detyruar ta ruajnë fshehtësinë. Ne ju mbështesim pavarësisht nga kallëximi penal.
- Varësisht nga rrethanat financiare, nga Zyra për Mbrojtjen e Viktimës, mund të merren shpenzimet, për shembull për terapi psiqike, për strehim urgjent apo shpenzimet e avokatit.

- Nën kushte të caktuara mundeni mbrenda 5 viteve nga vepra e fundit penale të parashtroni kërkesë (aplikoni) për zhdëmtim dhe shpagim. Ky afat vlenë për veprat penale të kryera nga 01.01.2007.

### **Cilat të drejta i keni ju në procedimet penale?**

- Gjatë marrjes në pyetje pranë policisë dhe organit ndëshkivor mund të shoqëroheni nga një person i besueshëm për ju.
- Ju mund të kërkontë që ju dhe i pandehuri sipas mundësisë të mos takoheni (vlenë për marrjet në pyetje dhe takimet e rastësishme).
- Ju mund të parashtroni kërkesë për ti parë aktet e organi ndëshkivor (të përndjekjes).
- Ju mund të shtroni kërkesë që juve t'ju komunikohen vendimet e rëndësishme. Këto janë për shembull njoftimet për lirim të pandehurit apo shfuqizimi i dëbimit.

### **Cilat të drejta i keni në qoftë se ndaj jush është ushtruar dhunë seksuale?**

- Ju mund të kërkontë që të merreni në pyetje nga një person i gjinisë së njëjtë dhe që një person i gjinisë së njëjtë të përkthej për ju.
- Ju mund t'i refuzoni deklaratat të cilat kanë të bëjnë me zonën tuaj gjenitale.
- Ju mund të parashtroni kërkesë që t'mos ballafaqoheni me të pandehurin.
- Ju mund të parashtroni kërkesë që gjatë marrjes në pyetje të paktën një person të jetë e/i gjinisë tuaj dhe që seanca gjyqësore të mabhet pa praninë e publikut.

### **Të drejtat e fëmijëve dhe të rinjëve (para se ti mbushin 18. vjet)**

- Viktima e mitur në parim nuk lejohet që të merret në pyetje më shumë se dy herë përgjatë gjithë procedimit penal.
- Marrjet në pyetje kryhen nga një person i specializuar enkas për këtë dhe sipas rregullit bëhet regjistrimi i zërit dhe videoregjistrimi.
- Ballafaqimi me të pandehurin lejohet të urdhërohet, vetëm në qoftë se këtë e kërkon fëmiju dhe në qoftë se të pandehurit ndryshe nuk mund t'i garantohet seanca ligjore, kjo don të thotë, në qoftë se marrja në pyetje diçka si përmes videoregjistrimit nuk mund të realizohet.